

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje e sistemit të detektimit të zjarrit, të monitorimit me kamera, të sensorëve të ndryshëm”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 31625100-4; 35125100-7; 71700000-5; 75251110-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,657,481 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e një) **Lekë (pa TVSH).**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ”IdentiTek” SH.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1 Ofertuesi duhet të paraqesë::

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e

kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë minimumi 3 punonjës me kualifikimet si më poshtë:
 - 1 (një) Inxhinier Elektrik/Elektronik/Informatik/Kompjuterik.
 - 1 (një) Punonjës/Specialist Elektricitist.
 - 1 (një) Specialist Elektronik/ IT

➤ Për punonjësit e sipërcituar duhet të paraqes:

 - Kontratë pune individuale;
 - Diplomë përkatëse për inxhinier Elektrik dhe Elektronik/ IT
 - Çertifikata kualifikimi (nëse disponojnë)
 - Për punonjesin (specialist elektrik) OE duhet të paraqesë dhe Dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik në profilin Elektrik e lëshuar nga një institucion shtetëror ose nga një organ i akredituar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pikat 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar natyrës së shërbimeve që prokurohen sqarojmë se stafi teknik i kualifikuar profesionalisht është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë elektrike, etj. Referuar natyrës së shërbimeve që prokurohen sqarojmë se stafi teknik i kualifikuar profesionalisht është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë elektrike, mbajtur në konsideratë faktin se shërbimi mund të përbejë rrezikshmeri për shkak të tensionit, kërkohet që specialisti elektrik duhet të jetë i pajisur me Dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik.

Kriteret e teknike te percaktuara sipas pikes 2 të "Kapacitetit Teknik" janë hartuar nga Z.Thoma Nika, në cilësinë e specialistit të fushës në njësinë e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 11.11.2025 Ora:10:00